DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
-III- Nr. Br. No. 0204-703/2
Data Datum Date 25.07.2012

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

Datë, 23.07.2012
Nr. 0204-703

**PËR:** Bojan Stojanovq Kryetar i Komunës së Graqanicës
Goran Lazić Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Graqanicës

**LËNDA: KËRKESË PËR RISHQYRTIMIN E LIGJSHMËRISË SË VENDIMEVE TË KOMUNËS SË GRAQANICËS NR. GB.98 dhe GB.50.**

Pranuar me datë, 26.06.212

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së Vendimi nr.gb.98, të datës 25.05.2012, për ndryshimin e Rregullores Komunale për Tarifat, Ngarkesat dhe Gjobat Komunale dhe Vendimi nr.gb.50, të datës 03.04.2012, për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores Komunale për Taksat, Ngarkesat dhe Gjobat Komunale të Kuvendit të Komunës së Graqanicës **KONSTATON** se:

- Vendimi nr.gb.98, të datës 25.05.2012, për ndryshimin e Rregullores Komunale për Tarifat, Ngarkesat dhe Gjobat Komunale dhe Vendimi nr.gb.50, të datës 03.04.2012, për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores Komunale për Taksat, Ngarkesat dhe Gjobat Komunale, janë në kundërshtim me praktikën e hartimit dhe miratimit të akteve të komunave. Procedurat e ndryshimit duhet të bëhet konformë nenin 12 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Udhëzimit Administrativ 2008/9.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, duke u bazuar në nenin 82 pika 2 e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale ***kërkon*** nga Komuna e Graqanicës që të ndërmarrin veprime konkrete që, Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale të departamentit të shërbimeve publike,bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural të harmonizohet me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Me respekt,

**Slobodan Petrović,**
**Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL,**

______________________

**Kopje:** *Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së*
*Drejtorëve të Departamenteve dhe Drejtorëve të Zyrave*
*Arkivit të MAPL-së.*

DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 0204-703/2
-III-
Data Datum Date 25.07.2012

# Republika e Kosovës
## Republika Kosovo-Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

Dana, 23.07.2012
Br. 0204-703

**Za:** Bojan Stojanovć Gradonačelnik Opštine Gračanica
Goran Lazić Predsedavajući Skupštine Opštine Gračanica

**PREDMET: ZAHTEV ZA RAZMATRANJE ZAKONITOSTI ODLUKA OPŠTINE GRAČANICA BR. GB.98 i GB.50.**

Primljeno dana, 26.06.212

Të nderuar/a

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom odredjenog prema Zakonu za lokalnu samoupravu Br. 03/L-040, dodatak XII Vladine Uredbe 02/2011 o poljima Administrativne odgovornosti kancelarije Premijera i Ministarstva, posle razmatranja zakonitosti odluke br.gb.98, od dana 25.05.2012, za izmenu opštinske uredbe o Tarifama,zaduženjima i opštinskim kaznama i Odluke br.gb.50, od dana 03.04.2012, za izmenu i dopunu opštinske uredbe o Taksama, zaduženjima i opštinskim kaznama Opštine Gračanica **KONSTATUJE da**:

- Odluka br.gb.98, od dana 25.05.2012, o izmeni opštinske uredbe o Tarifama, zaduženjima i opštinskim kaznama i Odluke br.gb.50, od dana 03.04.2012, o izmeni i dopuni opštinske uredbe o Taksama, zaduženjima i opštinskim kaznama,su u suprotnosti sa praksom izrade i usvajanja opštinskih akata . Procedure izmene treba da se urade prema članu 12 Zakona za lokalnu samoupravu i Administrativog Uputstva br. 2008/9.

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, na osnovu člana 82 tačka 2 Zakona za lokalnu samoupravue ***traži*** od Opštine Gračanica da preduzmu konkretne mere,da Odluka za izmenu i dopunu o taksama, zaduženjima i opštinskim kaznama sektora za javne službe,poljoprivrede,šumarstva i ruralnog razvoja da se uskadi prema zakonskim dipozicijama na snazi , u roku 30 dana od dana prijema zahteva za razmatranje akta .

S poštovanjem,

**Slobodan Petrović,**
**Zamenik Premijera i Ministar MALS-e,**

**Kopija:** *Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-e*
*Direktorima uprava i kancaleraija i*
*Arhivu MALS-e.*

Br./No. 96 98 25 MAY 2012

**ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА**
**KOMUNA E GRAÇANICËS**
**MUNICIPALITY OF GRACANICA**

Kuvendi Komunal i Graçanicës 25.05.2012

Në bazë të nenit 2 dhe 8 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal nr. 03/L -049, të nenit 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40, të nenit 8 pika (n) dhe 48 dhe aneksit ½ të Statutit e Komunës së Graçanicës, të Udhëzimit Administrativ nr. 2007/2 për të ardhurat vetanake komunale nr. 2007/3 të Ministrisë së Administratës së Pushtetit Lokal për përcaktimin e burimeve të të ardhurave vetanake, Kuvendi Komunal i Graçanicës në mbledhjen e mbajtur me 21.05.2012 miratoi këtë :

## VENDIM

### PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULORES MBI TARIFAT, NGARKESAT DHE GJOBAT KOMUNALE TË DEPARTAMENTIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE, BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

**Neni 1**

Miratohet Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e nenit 6 të Rregullores mbi tarifat, ngarkesat dhe gjobat komunale nr. G/b 78 dt. 28.09.2010.

**Neni 2**

Në nenin 6 paragrafi 6.5 :

**Shfrytëzimi i hapësirës para objekteve ku kryhen shërbimet hoteliere, tarifa mujore sipas zonave:**

Zona bisnese ........................................ 10€/m²

I zona ........................................ 8€/m²

II zona ........................................ 6€/m²

III zona ........................................ 4€/m²

Fshihet fjala mujore,

Shtohet fjala tremujore

**Neni 3**

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, për të gjitha lëndët - kërkesat që janë në procedurë, për të cilat nuk është lëshuar asnjë vendim mbi lëshimin dhe përdorimin e pronës komunale, llogaritja do të bëhet mbi bazën e këtij vendimi.

**Neni 4**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria e Shërbimeve Publike, Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

**Neni 5**

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi Komunal i Graçanicës.

Kryesuesi i Kuvendit

Goran Lazic

Gb 50 06 APR 2012

ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА
KOMUNA E GRAÇANICËS
MUNICIPALITY OF GRACANICA

Kuvendi Komunal i Graçanicë

Data 03.04.2012

Në bazë të Ligjit mbi Tregtinë e Brendshme nr. 2004/18, të ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit nr. 2011/04-L-005 dt. 08.07.2011, të nenit 3 dhe 13 të Statutit të Komunës së Graçanicës, Kuvendi Komunal në mbledhjen e mbajtur më 30.03.2012 miratoi këtë:

# V E N D I M

## PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORËS KOMUNALE MBI TAKSAT, NGARKESAT DHE GJOBAT KOMUNALE
## DHE
## PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORËS KOMUNALE MBI KUSHTET E PËRGJITHSHME HIGJIENIKE – SANITARE – TEKNIKE NË ASPEKTIN E MBROJTJES SË MJEDISIT, MBROJTJES NË PUNË, STABILIMENTEVE, PAJISJEVE DHE LOKALEVE TË PUNËS

### Neni 1

Miratohet Vendimi për ndryshimin e Rregullorës mbi taksat, ngarkesat dhe gjobat komunale i miratuar nga Kuvendi më datën 15.09.2010 nr. G/b 67. dt.21.09.2010, si dhe Vendimi për ndryshimin e Rregullorës mbi kushtet e përgjithshme sanitare – higjienike – teknike në aspektin e mbrojtjes së mjedisit, mbrojtjes në punë, pajisjeve dhe lokaleve të punës, të miratuara nga Kuvendi më 19.11.2010 me numër Gb 143. dt. 30.11.2010.

### Neni 2

Neni 7.7 në Rregullorën mbi taksat, ngarkesat dhe gjobat komunale fshihet .

### Neni 3

Neni 212 në Rregullorën mbi kushtet e përgjithshme higjienike – sanitare – teknike në aspektin e mbrojtjes së mjedisit, mbrojtjes në punë, pajisjeve, stabilimenteve dhe lokaleve të punës fshihet .

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi është përgjegjës Departamenti i Inspektoriatit.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi nga data e miratimit nga Kuvendi Komunal i Graçanicës.

Dërgohet: Arkivit, Departamentit të Buxhetit, Financave dhe Zhvillimit Ekonomik, Departamentit të Inspektoriatit dhe Departamentit të Urbanizmit, Planifikimit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Kryesuesi i Kuvendit

Goran Lazić